

Nr.18

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR KLIMATIK

Qershor 2018

Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2018





BULETINI MUJOR KLIMATIK

Qershor 2018

Nr. 18

Përmbledhje. Muaji Qershor 2018 ishte ndryshe nga çdo muaj tjetër në historinë klimatike. Ai u karakterizua me temperatura mesatare të ajrit me vlera mbi normë me rreth $+1.4^{\circ}\text{C}$ dhe me vranësirë të pranishme në shumicën e ditëve, si dhe reshje në sasi rreth 2 herë më të larta se norma. Reshjet u vrojtuan në një numër ditësh mbi pragun 1.0mm më të madh se norma me rreth 1.8 herë; ndërsa ato mbi pragun 10.0mm deri në 2.2 herë më shumë.

Një vëmendje e veçantë i dedikohet vlerësimit meteorologjik për muajt gusht 2018 deri në janar 2019 sa i takon reshjeve dhe temperaturave të pritshme.

Summary. The month of June 2018 was different from any other month in climatic history of June. It was characterized by an average air temperature with a value above about 1.4°C and with the rainfall present in most days, as well as rainfall about twice as high as the norm. Rainfall was observed in a number of days above the 1.0mm threshold larger than the rate of about 1.8 times; while those above the threshold 10.0mm up to 2.2 times more.

Particular attention is dedicated to the meteorological assessment for the months of August 2018 to January 2019 as regards the expected precipitation and temperatures values.

SITUATA SINOPTIKE

Gjatë muajit qershor ashtu si dhe në muajin e mëparshëm, shumica e reshjeve pati karakter konvektiv për shkak (ndër të tjera) të “forcing”-ut të shkaktuar nga ngrohja e sipërfaqes së tokës gjatë pasditeve. Do të veçonim shiun e rënë në Tiranë në datën 22, ora 14:00 lokale, ku në 30 minuta ranë rreth 25 mm shi. Pjesa tjetër e reshjeve i dedikohet 2 sistemeve atmosferikë që përshkuan dhe vendin tonë, përkatësisht në datat 23 dhe 27 qershor 2018.

Sistemi atmosferik i orëve të para të datës 23 ishte një front relativisht i gjatë, që erdhi nga veriu i Ballkanit paraqitur në figurën Nr. 1.




Figura Nr.1 - Situata sinoptike e datës 23 qershor 2018, 12:00 UTC.

Një veçori e tij ishte shpejtësia e ulët e zhvendosjes. Kjo bëri që të regjistroheshin reshje intensive, të cilat në qendër të vendit arritën deri 20 mm në 30 minuta (në Tiranë).

Në një zonë gjeografike të gjerë rreth Shqipërisë dhe gjatë 8 orëve të para të datës 23 qershor u regjistruan 24 890 rrufe.

Figura Nr. 2. Pamje e hapësirës kur u vrojtua një numër mjaft i lartë i rrufeve më datë: 23.06.2018.

Në datën 27 qershor 2018 një vijë instabiliteti ndikoi mbi vendin tonë, sidomos Jugun e vendit. Ajo solli reshje intensive në Korçë: prej orës 18:00 deri në orën 06:00 ranë 75.0 mm reshje shi (sipas SHMU). Kjo vijë instabiliteti ishte pjesë e një sistemi atmosferik bllokimi në formë “Omega” në Evropë, ku një kreshtë në sipërfaqen 500 hPa shtrihej nga veri-perëndimi i Afrikës drejt Detit të Veriut dhe 2 sisteme kryesore ciklonare gjendeshin në perëndim dhe në lindje të saj. Një luginë në sipërfaqen 500 hPa në lindje të kësaj kreshte krijoi kushte të favorshme për shtrëngata dhe stuhi të shumta. Në afërsi të vendit tonë dominonte një “vorteks” i gjerë ciklonik në shtresat e mesme dhe të larta të atmosferës me qendër në Adriatikun e Jugut.












Një konveksion mjaft i zhvilluar i pasur në lagështirë u vrojtua përreth këtij vorteksi, veçanërisht në anën e tij lindore, nën regjimin e adveksionit të masave të ngrohta të ajrit.

Prania e reshjeve gjatë muajit u shoqërua dhe me vranësirë të pranishme pothuajse në çdo ditë të muajit qershor 2018. Për ilustrim një pamje e qiellit dhe vranësirës mbi Tiranë më datë 30.06.2018 jepet në figurën Nr.3.



Figura Nr.3 – Pamje panoramike e qiellit mbi Tiranë, datë: 30 qershor, ora 14:00, tipike me vranësirë dhe karakteristike pothuajse për gjithë muajin qershor 2018 (foto: P. Zorba).

Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet (figurat në vijim Nr. 4/1÷4/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik për muajin: Qershor 2018.



KARAKTERISTIKAT KRYESORE METEOROLOGJIKE TË MUAJIT: QERSHOR 2018 DHE DISA KONSIDERATA MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE

TEMPERTURAT E AJRIT – gjatë muajit qershor 2018, shënuan vlera lehtësisht mbi normë pothuajse në të gjithë territorin e vendit tonë. Ato ruajtën një tendencë rënie nga fillimi deri në fund të muajit, në ndryshim me karakteristikat tipike të këtij elementi meteorologjik për këtë muaj. Kjo rënie relative graduale, ishte si rezultat i mbizotërimit të motit me vranësira e reshje; të cilat në veçanti në javën e fundit 24÷30 qershor 2018 sollën dhe një shmangie negative duke evidentuar vlera në normë, siç kjo pasqyrohet dhe në figurën Nr. 7. Në mënyrë të veçantë kjo shmangie nën normë vërehet për vendin tonë në javën e tretë pjesa jugë lindore e vendit si dhe më e theksuar në javën e katërt, ku hapësira e Shqipërisë dallon për ulje me rreth $1\div 3^{\circ}\text{C}$ të vlerave të temperaturave mesatare të ajrit nën vlerat e periudhës shumëvjeçare 1981÷2010. Në paraqitjet grafike dhënë në figurat Nr. 4/1 ÷ 4/12 si dhe në figurën Nr. 7, jepen pamjet e këtij treguesi me anomalitë përkatëse në shkallë kontinentale për çdo javë.

Pas përpunimit të informacionit, kontrollit dhe verifikimeve të nevojshme, në figurën Nr. 5 paraqiten grafikisht të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për 30 vendmatje meteorologjike të vendit tonë si dhe ndryshimet me vlerat e normës referuar periudhës 1961÷1990, të cilat evidentojnë një shmangie prej afro $+1.4^{\circ}\text{C}$. Përfashtime vërehen vetëm në pak zona VL e JL.




Figura Nr. 5 – Vlerat mesatare të temperaturës së ajrit për muajin qershor 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës 1961÷1990.

Ndërsa, në shkallë kontinentale ndryshimi i temperaturave mesatare të ajrit paraqitet në figurën Nr. 6, ku jepen dhe anomalitë krahasuar me periudhën 1981÷2010.




Figura Nr. 6 – Vlerat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin qershor 2018 për kontinentin European dhe anomalitë përkatëse ndaj periudhës shumëvjeçare 1981÷2010, sipas NOAA-s.

Ndërkohë, temperaturat maksimale të ajrit vijuan të ruajnë një tendencë të lehtë me shmangie vlerash mbi normë, më të lartë se ato të vlerave minimale, të cilat paraqiten në figurën Nr.8.




Figura Nr. 7 – Anomalitë në vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit qershor 2018, sipas NOAA-s.




Figura Nr. 8 – Vlerat mesatare të temperaturës maksimale të ajrit për muajin qershor 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.

Në shkallë kontinentale vendi ynë në javën e parë të muajit (3÷9 qershor 2018), siç shihet dhe në figurën Nr. 9 bën pjesë në zonat me temperaturat maksimale më të larta në kontinent.




Figura Nr. 9 – Vlerat mesatare të temperaturave maksimale të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit qershor 2018, sipas NOAA-s.

Në vendin tonë temperaturat maksimale të ajrit u shënuan pikërisht në fillim të muajit. Ndonëse, nuk u thyen rekorde ato ishin gjithashtu dhe me kohëzgjatje të shkurtër. Në figurën Nr. 10 jepen të dhënat e temperaturave maksimale absolute për disa vendmatje meteorologjike.




Figura Nr. 10 – Vlerat maksimale absolute të temperaturës së ajrit për muajin qershor 2018 për disa vendmatje meteorologjike.

Një tregues i rëndësishëm klimatik është dhe ai i numrit të ditëve me temperaturë mbi prapun 35°C, i cili për vendmatjen meteorologjike të Tiranës paraqitet në figurën Nr. 11.




Figura Nr. 11 – Të dhënat e numrit të ditëve me temperatura të ajrit mbi prapun 35.0°C për muajin qershor 2018 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.

NETËT TROPIKALE Gjatë periudhës së ngrohtë në vendin tonë në vitet e fundit gjithnjë e më shumë po bëhen prezent netët tropikale (netët kur temperatura minimale e ajrit nuk zbret nën prapun 20.0°C). Në një analizë më të detajuar të këtij treguesi për vendmatjen meteorologjike të Tiranës, paraqitur në figurën Nr. 12, vërehet qartë se edhe gjatë muajit qershor 2018 u ruajt po ajo karakteristikë si dhe në vitet e fundit.




Figura Nr. 12 – Numri i netëve tropikale për muajin qershor, për vitet 2002 deri 2018, për vendmatjen meteorologjike të Tiranës si dhe vlerat e normës.

Kjo dukuri ishte në vijim të situatës së përgjithshme të temperaturave të ajrit, të cilat edhe sa i takon vlerave minimale ditore ishin mbi normë me rreth +1.3°C. Në vijim në figurën Nr.13 paraqiten këto të dhëna për disa vendmatje meteorologjike përfaqësuese për të gjitha zonat e nënzonat klimatike të vendit tonë. Gjithashtu në figurën Nr.14 jepen vlerat e temperaturave minimale absolute të ajrit të vrojtuar gjatë muajit qershor 2018, të cilat vetëm në zonat e larta shënuan vlera pranë nivelit të 0°C, por gjithësesi me kohëzgjatje të shkurtër.





Figura Nr. 13 – Vlerat mesatare të temperaturës minimale të ajrit për muajin qershor 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.



Figura Nr. 14 – Vlerat minimale absolute të temperaturës së ajrit për muajin qershor 2018 për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë.

KLIMA URBANE – Tashmë është i njohur fakti që në qytetet e mëdha si dhe me impaktin e përcjellë nga ndryshimet klimatike, në tërësi vlerat e temperaturës së ajrit janë më të larta se ato të normës kundrejt zonave periferike apo jashtë këtyre qendrave të mëdha urbane. Në figurën në vijim Nr. 15 jepen të dhënat për Tiranën për muajin qershor, për vitet 2012 deri 2018. Për muajin qershor 2018 ndryshimi është me plus 2.2°C kundrejt vlerave të normës; përkundrejt një vlere +1.4°C që siç u përmend më lart ishte shmangia në shkallë vendi për pjesën më të madhe të vendmatjeve meteorologjike.

Figura Nr. 15 – Të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin qershor për vitet 2012÷2018 dhe vlerat e normës referuar periudhës 1961÷1990 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.



RESHJET ATMOSFERIKE Për muajin qershor 2018 u vrojtua një numër i lartë ditësh me vranësirë dhe reshje. Mjafton ti referohemi produkteve të parashikimit sipas modelit Aladin, dhënë në figurën Nr.16, dukshëm dallohet se për çdo ditë të këtij muaji parashikohej për reshje, pavarësisht nga madhësia e pritshme.




Figura Nr.16 – Parashikimet ditore 24 orëshe sipas modelit Aladin për reshjet atmosferike për muajin qershor 2018.

Sasitë e reshjeve, natyrisht pasi vlerat e tyre u përpunuan, kontrolluan dhe u bënë verifikimet e nevojshme të informacioneve të ardhura nga vendmatjet meteorologjike, shënuan vlera rreth 200% referuar madhësive të normës.




Figura Nr. 17. – Vlerat e sasisë së reshjeve për muajin qershor 2018 për 52 vendmatje meteorologjike të vendit tonë si dhe vlerat përkatëse të normave referuar periudhës mesatare shumëvjeçare 1961÷1990.

Një informacion tjetër me rëndësi është dhe vlerësimi i reshjeve për muajin qershor në kontinentin European dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981÷2010, të cilat janë paraqitur në vijim në figurën Nr.18, ku vendi ynë dallon për anomali dhe reshje mbi vlerat e periudhës shumëvjeçare.




Figura Nr. 18. Reshjet për muajin qershor në kontinentin European dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981-2010, sipas NOAA-s.




Figura Nr. 19. – Vlerat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm për muajin qershor 2018 për 52 vendmatje meteorologjike të vendit tonë.

Numri i ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm për muajin qershor 2018 ishte më i lartë se vlerat e normës me 1.8 herë, ndërsa ajo që duhet evidentuar si një element i rëndësishëm në lidhje me ndryshimet klimatike të viteve të fundit është fakti se sa i takon numrit të ditëve me reshje mbi pragun 10.0 mm rezulton se ky tregues shënon një rritje akoma më të lartë me 2.2 herë kundrejt vlerave të normës.




Figura Nr. 20. – Vlerat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragun 10.0 mm për muajin qershor 2018 për 52 vendmatje meteorologjike të vendit tonë.




Figura Nr. 21. Reshjet maksimale 24 orëshe për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë për muajin qershor 2018.

Lagështia e tepërt, bëri që në tokat bujqësore në zona të rrethit të Korçës, kulturat bujqësore si gruri, patatet, fasulet, etj, u prishën në shumë fshatra, ndërsa breshëri në disa zona shkaktoi dëme.



Figura Nr. 22. Pamje nga reshjet intensive më datë 24 qershor 2018 në Korçë, shoqëruar me problematika në transport dhe dëme në fushën e bujqësisë.



Figura Nr. 23. Pamje nga reshjet intensive shoqëruar dhe me breshër më datë 22 qershor 2018 në Tiranë, që shkaktuan probleme në qarkullimin rrugor.

STUHITE - Muaji qershor 2018 u karakterizua nga një numër i lartë i stuhive sipas qendrës eksperimentale të monitorimit dhe parashikimit european ESTOFEX. Gjithsejt u shënuan 10 stuhi të kategorisë së parë, 12 stuhi të kategorisë së dytë, të cilat paraqiten dhe në grafikun e dhënë në figurën Nr. 24, si dhe një stuhi e kategorisë së tretë dhe më ekstreme apo të vërtetuar më rrallë ndër vite. Ndërkohë, nuk munguan dhe stuhi me karakter lokal dhe rezultat i dukurive orografike, që kryesisht u vërtetuan në zonat malore, (gjithsejt 5 të tilla në nivel kontinental).



Figura Nr.24. Numri i stuhive të kategorisë 2, sipas viteve për muajin qershor, referuar sistemit ESTOFEX.

Parashikimi i stuhive i datës 7 qershor 2018 (Figurë Nr.25) për datat 8 e 9 qershor vlerëson një shkallë të lartë probabiliteti për stuhi të kategorisë 3, për Slloveninë dhe veriun e Kroacisë, duke parashikuar breshër intensiv dhe me dimensione të mëdha si dhe për zhvillime konvektive të shoqëruara dhe me erëra të forta (windgust). Gjithashtu ky vlerësim tregon për një kategori 1 dhe 2 të pritshme për V dhe VL e Italisë, JL e Austrisë, JP të Hungarisë dhe në tërësi Kroacinë, ku parashikoheshin zhvillime konvektive, breshër dhe shtrëngata shiu me intensitet të lartë. Për detin Adriatik gjithashtu evidentohet mundësia për tornado dhe për praninë e reshjeve intensive dhe breshrit. Në këtë vlerësim kategoria 1 dhe 2 e rrezikut jepet dhe për Bosnje Hercegovinën, Malin e Zi, pjesë të Serbisë dhe Shqipërinë, ku nuk do të mungojnë breshëri si dhe me një shkallë me një shkallë më moderuar do të jenë të pranishme dukuri të zhvillimeve konvektive, me erëra të forta dhe rreshe dhe shtrëngata shiu me intensitet të lartë, të vërtetueshme për periudha të shkurtra kohore.

Sa i takon stuhive të kategorisë së tretë, ato kryesisht referuar vlerësimeve nga viti 2006 e deri më sot, tregojnë se janë vërtetuar në shumicën e rasteve në muajin korrik (10 raste) dhe qershor (5 raste).






Figura Nr.25. Situata e pritshme për stuhi të kategorive 1, 2 dhe 3 më datë 8 dhe 9 qershor 2018 në kontinentin European.


Reshjet - Në vijim tregohen anomalitë e tyre, që pritet të mbizotërojnë në kontinentin European dhe zonën e Mesdheut për muajt: gusht 2018 deri janar 2019 (figurat Nr.26/1÷26/7).

Ky informacion rinovohet në javën e parë të çdo fillim muaji.


Hartat bazohen në produktet e Qendrës Evropiane të Parashikimit Afat Mesëm të Motit (ECMWF - European Centre for Medium-Range Weather Forecasts) referuar sistemeve të parashikimit sezonal S4, për temperaturën dhe reshjet, të cilat mundësojnë vlerësimin e anomalive të këtyre treguesve bazuar në devijim mesatar të marrë nga modelet e klimës.




Hartat evidentojnë me ngjyrat përkatëse zonat ku pritet që të jetë më ngrohtë apo më ftohtë për temperaturën apo për reshjet me lagët apo më thatë. Natyrisht duhet mbajtur në konsideratë se sa më shumë i largohemi datës së këtyre vlerësimeve aq më pak të sakta vlerësimet parashikuese bëhen. Për më shumë mund të konsultoni dhe “web site” e ECMWF.




Vlerësimet mbi anomalitë sezonale të reshjeve të shprehura (në mm) përkundrejt vlerave mesatare shumëvjeçare sipas vlerësimeve të Qendrës Evropiane të Parashikimit Afat Mesëm të Motit, të pritshme për muajt në vijim janë dhënë në figurat Nr. 26/1÷26/7, i referohet datës 1 korrik 2018.







Nga një vështrim i përgjithshëm i këtyre pamjeve rezulton se hapësira e vendit tonë, për muajt në vijim deri në nëntor pritet të jenë me reshje mbi vlerat e normës. Dallon për mungesë dhe një situatë të pritshme me më pak reshje muaji dhjetor 2018 paraqitur në figurën Nr.26/5, që pasohet përsëri me një muaj janar 2019 me reshje të pritshme mbi normë.




Temperaturat e ajrit sipas këtyre vlerësimeve pritet të kenë vlera pranë ose mbi normë për të gjithë muajt nga gushti 2018 deri në janar 2019.

Në vijim në figurën Nr. 27/1 vetëm për muajin dhjetor 2018, kur priten dhe shmangiet më të larta ndaj normës, si dhe për muajin janar 2019 në figurën Nr. 27/2 jepen për ilustrim hartat me shmangiet e pritshme që pritet të kenë vlerat e temperaturave të ajrit (për vendin tonë mbi normë).



“Zonat Me Kufizime Natyrore Në Evropën Juglindore: Dhe Rekomandimet Për Politika.”

Më datë 6 qershor 2018 u organizua një workshop në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Shqipërisë si dhe me mbështetjen e GLZ-Shkup, me titull: “Evidence-Based Policy Making”, ku u prezantuan nga Prof.Dr. Petrit ZORBA, rezultatet e punës, të pasqyruara në publikimin me titull: “Areas with Natural Constraints in South East Europe: Assessment and Policy Recommendations”.



Ky është një publikim i vitit 2017 (203 faqe në gjuhët anglisht dhe shqip) i realizuar në kuadrin e një projekti për përcaktimin dhe vlerësimin e zonave me kushtëzime natyre, me qëllim përmirësimin dhe përqasjen e këtyre vendeve për të patur një zhvillim rural të qëndrueshëm, nëpërmjet një menaxhimi të integruar të burimeve ujore dhe pyjore në vendet si Bosnja H., Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Shqipëria, në kontekstin e integritetit dhe në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian.

Një nga objektivat kryesore të programit ZHRMIBUP është krijimi i parakushteve për hartimin e politikave të bazuara në prova dhe në përputhje me standardet e BE-së për të takon objektivat mjedisore në zhvillimin rural dhe bujqësi. Në linjë me këtë objektiv, zhvillimi i vlerësimeve për politikat e bazuara në prova dhe analiza e boshllëqeve mbështetet në dhënien e rekomandimeve të politikave në lidhje me zhvillimin rural duke përfshirë zona me kufizime natyrore dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në vendet e Evropës Juglindore.

Objekti i detyrës për ZKN-të ishte zhvillimi i metodologjisë për karakterizimin, hartëzimin dhe përcaktimin e zonave me kufizime natyrore në vendet e EJT dhe dhënia e rekomandimeve për politika në shtetet e EJT në përputhje me metodologjitë dhe standardet e BE-së.

Rezultatet mund të përmbledhen në sa vijon: - Qasja metodologjike dhe materialet udhëzuese për karakterizimin dhe hartëzimin e ZKN-ve; - Vlerësimi dhe rekomandimet për politikat për karakterizimin dhe hartëzimin e zonave me kufizimet natyrore në vendet e EJT të pajtueshme me metodologjinë dhe standardet e BE-së; - Vlerësimi i politikave, vlerësimi i disponueshmërisë së të dhënave, vlerësimi i boshllëqeve tek të dhënat, ofrimi i strukturës institucionale dhe vlerësimi i implikimeve të qasjes ndaj ZKN-ve në nivel rajonal dhe kombëtar.

Zonat me Kufizime Natyrore (më parë të quajtura Zonat më Pak të Favorshme) në rajonet malore ose në zonat e tjera që përballen me kufizime natyrore dhe kufizime specifike të tjera mbështeten në Bashkimin Evropian nga buxheti për Politikën Bujqësore të Përbashkëta.

Synimi i skemës është të kontribuojë në mirëmbajtjen e zonave rurale dhe ruajtjen dhe promovimin e sistemeve të qëndrueshme të fermave duke inkurajuar përdorimin e vazhdueshëm të tokës bujqësore. Me qëllim të garantojë efikasitetin e një mbështetjeje të tillë, pagesat janë të destinuara për kompensimin e fermerëve për të ardhura dhe kosto shtesë të lidhura me disavantazhet natyrore të zonës në fjalë.

Ndihma për Zonat më Pak të Favorshme në Bashkimin Evropian (BE) daton në vitin 1975. Që atëherë, ajo ka kaluar disa reforma që kanë trajtuar shpërndarjen rural në drejtim të rritjes së fokusit për ruajtjen e përdorimit tokës bujqësore dhe përfitimeve mjedisore. Rregullimi aktual për Zonat me Kufizime Natyrore në periudhën e programimit 2014-2020 mund të gjendet në tekstin e ligjit për Zhvillimin Rural, në Nenin 32 të Rregullores së BE-së 1305/2013.

Zonat që përballen me kufizime natyrore janë veçanërisht të ndjeshme dhe preken nga ndikimet mjedisore. Ekzistojnë të paktën dy çështje mjedisore të mëdha që kanë ndikim të konsiderueshëm mbi këto zona: ndryshimet klimatike dhe degradimi i tokës. Sektori i bujqësisë i rajonit jugperëndimor është i prekur tashmë nga ndikimet klimatike. Ngjarjet e motit ekstrem (përmytjet, thatësirat, dëmtimet e ngricave, etj.) kanë qenë më të shpeshta dhe kanë zvogëluar tashmë prodhimtarinë bujqësore kohët e fundit në disa rajone. Fermerët që kryejnë aktivitetin bujqësor të tyre në ZKN-të e mundshme karakterizohen nga rezistencë dhe kapacitete përshtatëse më të ulëta ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht për shkak të rendimentit dhe të ardhurave më të vogla të raportuara në këto ferma. Disa raporte për ndryshimet klimatike paraqesin dobësi të lartë dhe kapacitet përshtatëje më të ulët në sektorin bujqësor në vendet e BPP.

Për zhvillimin e vlerësimit u zgjodh një grup prej 20 ekspertësh shumë të kualifikuar nga vendet/territoret e rajonit që përfaqësonin institucione të ndryshme duke përfshirë Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Mjedisit, entet kërkimore dhe arsimore dhe sektorin e shoqërisë civile në rajon.

Për vendin tonë grupi i ekspertëve përbëhej nga P. Zorba, I. Salillari, F. Çela, G. Gjeci, E. Zhllima. Gjithashtu ishin të përfshirë dhe ekspertë nga institucionet e BE, SWG, CIHEAM, ISPRA, etj.; A. Hagyo, J.M. Terres, P. Zdruli, O. Cukaliev, B. Ilic, B. Mohr, E. Gavrilova, D.P. Gjorgjieska, A. M. Stojcheska, etj.

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.

To read the other bulletins you are welcome to visit the respective web site, by clicking on the link of IGEWE.



<http://www.geo.edu.al>

Editorial Board:

Prof.Dr. Petrit ZORBA - Head of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Prof.Dr. Sylë TAHIRSYLAJ - University of Prishtina – Republic of Kosova.

Dr. Albana HASIMI - Member of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Subject Editors (Co-Editors):

Dr. Uarda GJOKA, Institute of Applied Nuclear Physics, Tirana University, Albania.

External Reviewers:

Dr. José A. GUIJARRO - AEMET – Madrid, Spain.

Editorial Board approved by the Director of IGEWE – Prof.Assoc.Dr. Fatos HOXHAI

Ky buletín u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Klimës & Mjedisit të IGJEUM sipas rubrikave si vijon:

This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Climate & Environment by rubrics as follow:

Data digitalization: A. Hasimi, E. Çomo, A. Bardhi, M. Marku, A. Gjoni.

Data control, verification and elaboration by appropriate software: Prof. P. Zorba, Ing. A. Gjoni.

Evaluation of monthly synoptic situation: M.Sc. M. Marku.

Evaluation of monthly meteorological characteristics and climate change: Prof. P. Zorba.

Scientific information: "Areas with Natural Constraints in South East Europe: Assessment and Policy Recommendations" Shkup, 2017. Summary by / Përmbledhje nga: Prof. P. Zorba.



"Buletin Mujor Klimatik"
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2018.

